

**2 Fushatë ndërkombëtare e sindikatës Unia Për ndalimin e asbestit në gjithë botën**

**3 Reforma tatimore & financimi i AHV/AVS (STAF/ RFFA) Sigurimet Shoqërore: Çka ndryshon me 2020?**

**4 Tubime informative në gjuhën shqipe Në Bernë e Cyrih nga Unia, në Biel nga Mowendo**

Nr. 1 | shkurt 2020 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

## Iniciativa për pensionin e 13-të të AHV/AVS-it Puna jonë meriton pensione të mira



Pamje nga aksionet në kuadër të Grevës së Grave 2019 me kërkesë edhe për pensione më të larta të pleqërisë së AHV/AVS-it

**Kushdo që ka punuar një jetë të tërë, do të duhej të mund të bënte një jetë me dinjitet. Në parim, të gjithë njerëzit pajtohen me këtë konstatim. Mirëpo pensionet e pleqërisë gjenden para sfidave të mëdha dhe gjendja është duke u përkeqësuar. Pasi pensionet po zvogëlohen – edhe pse ekonomia po rritet.**

Gabriela Medici, SGB

### Ulja e pensioneve ...

Pensionet e pleqërisë AHV/AVS herën e fundit që u rritën ishte në vitet e 70'ta. Që nga atëherë pensionet vetëm se janë përshtatur përmes të ashtuquajturit indeks të përzier. Si rezultat, pensionet çalojnë pas pagave. Premitë të sigurimeve shëndetësore në rritje kanë një pjesë në rritje të pensionit të AHV/AVS-it, andaj mbetet gjithnjë e më pak për të jetuar. Në anën tjetër, gjithnjë e më shumë po duhet të paguhet në shtyllën e dytë (të fondit pensional). Megjithatë, pensionet e fondit të pensioneve ulen nga viti në vit. Sot, gjithnjë e më shumë njerëz të siguruar janë të indinjuar se ata duhet të paguajnë më shumë në shtyllën e dytë, që të marrin më në fund të fundit më pak pension. Për më tepër, shumë gra nuk janë të siguruar në shtyllën e dytë (të fondit pensional) – ose marrin vetëm përfitime pensioni shumë të ulët nga fondi pensional.

### ... dhe frigësimi

Në të njëjtën kohë, punëdhënësit, bankat dhe kompanitë e sigurimeve duan të na bëjnë të besojmë se sigurimi i pleqërisë AHV/AVS

po përballet me kolaps financiar. Ata po bëjnë presion në uljen e pensioneve dhe për rritjen e moshës së pensionit. Në fakt, ata duan të shesin sa më shumë produkte të kolonës së 3-të («vullnetare»). Sepse ata fitojnë para me të. Ata nuk fitojnë asgjë nga AHV/AVS-i. Përkundrazi: ata që fituesit shuma tejet të larta paguajnë shumë më shumë në AHV sesa do të marrin ndonjëherë pension. Vetëm në AHV/AVS ata dhe punëdhënësit bashkë-financojnë pensionet e AHV/AVS të molerëve dhe shitësve. Në shtyllën e 3-të, secili person paguan i vetëm.

### Kundërofenziva e sindikatave

Kushtetuta Federale që gati 50 vjet e ka bërë të qartë se përfitimet nga pensioni duhet të na mundësojnë të jetojmë një jetë të mirë në pleqëri. Por realiteti vazhdon të na largoi nga kjo. Në vitet e ardhshme, do të vendoset nëse Zvicra e pasur do të sigurojë skema të denja dhe solidare pensioni, apo nëse bankat dhe kompanitë e sigurimeve do të mbizotërojnë me privatizimin e skemës së pensioneve

që ata dëshirojnë. Prandaj SGB/USV ka filluar një iniciativë për një pension të 13-të të AHV/AVS-it. Pasi, kushdo që ka punuar gjithë jetën, edhe meriton një pension të mirë. Nisma është e thjeshtë, por mbresëlënëse: kërkon një pension të 13-të të AHV/AVS, siç është bërë e zakonshme për shumë njerëz me pagën e 13-të. Bazuar në një përllogaritje mujore, kjo nënkupton një rritje prej 8.33% të pensioneve të AHV/AVS-it. Për një familje, fjala bie, të një shoferi të tramvajit dhe një gruajë shitëse me kohë të pjeshme dhe me një fëmijë, iniciativa rezulton në rreth 300 CHF pension më shumë në muaj. Nisma gjithashtu parashikon që përfituesit e të ardhurave suplementare gjithashtu

të përfitojnë nga pensioni i 13-të. Posaçërisht pensionistët më të varfër duhet të ndiejnë përmirësimin.

### Përmirësim për gratë dhe njerëzit me të ardhura të ulëta

Kjo rritje e pensioneve të AHV/AVS është mënyra më e mirë për të përmirësuar menjëherë situatën e pandierë të njerëzve me të ardhura të ulëta dhe grave në moshë pensioni. Kjo është arsyeja pse një rritje e pensioneve është përgjigjja e duhur sociale. Sidomos për gratë, një vit pas grevës së suksesshme të grave, kjo do të thotë përparim i vonuar dhe konkret për pensionet e grave!

### Angazhohuni me 8 mars për pensionin e 13-të të AHV/AVS-it

Pensionin e AHV/AVS-it është veçanërisht i rëndësishëm për gratë: Sepse vetëm AHV/AVS merr parasysh punën e edukimit dhe përkujdesit gjatë llogaritjes së pensioneve. Dhe për shkak se gratë shpesh punojnë me kohë të pjeshme, është e vështirë për to të kursejnë një pension të mirë në shtyllën e dytë. Prandaj gratë varen nga një pension i mirë i AHV/AVS-it! Gratë meritojnë jo vetëm më shumë pagë, por edhe një pension më të lartë: Po pensionit e 13-të të AHV/AVS-it! Me 8 mars do të zhvillohen aksione të ndryshme: Lajmërohu në Unia të regjionit Tënd, ku janë planifikuar një sërë aktivitetesh!

## Editorial



### Të dashura kolege, të dashur kolegë

Luftëra dhe mjerim refugjatësh, emergjencë klimatike, zbritje pensionesh, vende pune të rrezikuara – këta tituj mund të na frikësojnë. Mirëpo frika është një këshillë e keqe. Frika është kapitali politik i figurave udhëheqëse megalomane dhe demagogëve të krahut të djathtë që është duke u përhapur gjithandej.

Ne ka kohë që e njohim atë: frika ishte lubrifikuesi për ngritjen e SVP/UDC-së ksenofobe, për t'u bërë partia më e madhe në Zvicër. Edhe tani para nesh kemi një fushatë tjetër frike. Me «iniciativën anuluese», SVP/UDC dëshiron të shfuqizojë lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të anulojë të gjitha masat shoqëruese për të mbrojtur pagat dhe marrëveshjet kolektive. Ajo dëshiron që timonin e kohës të kthejë mbrapa dhe ti kthehet sistemit diskriminues të kuotave. Shtypja e pagave, ashpërsimi i konkurrencës dhe puna e padeklaruar (në të zehtë) do të ishin si pasojë. Të lumtur me këtë gjendje do të ishin vetëm shfrytëzuesit më të këqij dhe kompanitë e dumpingut të pagave.

Me këtë unë kam emëruar sfidat më të madhe politike të vitit aktual. Miratimi i kësaj nisme do të ishte një fatkeqësi për të gjithë punëtorët. Ne patjetër duam ta parandalojmë atë. Fushata jonë «Paga më të ulëta, shfuqizimi i të drejtave? Jo iniciativës së SVP/UDC!» është gati për të filluar. Secila votë, çdo kontakt, çdo bisedë kontribuon në një JO të qartë në 17 maj. Unë gjithashtu llogarisë në mbështetjen Tëndë.

Edhe ashtu viti ynë i punës është shumë i ngarkuar. Për këtë kujdesen jo vetëm çështjet tjera kyçe politike siç është iniciativa jonë për një pension të 13-të të AHV/AVS, greva e klimës më 15 maj dhe fushata e pagave të barabarta, por mbi të gjitha demonstrata jonë e madhe kombëtare për paga më 19 shtator. Për të gjitha këto ne gjithashtu kemi nevojë për kontributin Tënd. Pasi vetëm së bashku mund të zhvillojmë forcën e vetme që mund të kapërcëjë frikën dhe t'i japë formë shpresës për një të ardhme më të mirë: Solidarizimi!

Vania Alleva

## News

## Arsimim për migrantët në degën e gastronomisë. Për shanse më të mira në tregun e punës!

Projekti arsimor Integresso u ofron punonjësve migrantë përcaktimin e vendndodhjes së tyre profesionale dhe përmirëson qasjen në arsimim dhe formimit profesional dhe kështu rrit edhe shanset në tregun e punës. Programi arsimor përfshin një vlerësim të bagazhit profesional, rikualifikimin e aftësive themelore dhe trajnimin individual. Pjesëmarrësit paguajnë 250 CHF për të gjithë kursin arsimor, anëtarët e Unia paguajnë vetëm 100 CHF.

### I interesuar?

Eja në njërin nga manifestimet tona informuese!  
Bernë: Të hënën, me 17.02.2020, 15.00 – 17.00h,  
ECAP Bern, Freiburgstrasse 139 c  
Biel: Të mërkurën, me 19.02.2020, 18.00 – 20.00h,  
ECAP Biel, Spitalstrasse 11

Informata tjera në [www.integresso.ch](http://www.integresso.ch) ose tek:  
ECAP Bern, Tel. 031 381 81 33, [jsoldo@ecap.ch](mailto:jsoldo@ecap.ch)  
Unia Bern, Tel 031 385 22 22, [bern@unia.ch](mailto:bern@unia.ch)



## Sa migracion ka tek ne? Ekspozita «Homo migrantët. Dy milion vjet në lëvizje»

Muzeu Historik i Bernës ka hapur ekspozitën «Homo migrantët. Dy milion vjet në rrugëtim». Udhëtimi fillon me njerëzit e parë në Afrikë, tregon fillimin e përhapjes së tij në të gjithë botën dy milion vjet më parë dhe vazhdon deri në ditët e sotme në Zvicër. Përveç lëvizjeve kryesore të migracionit që formojnë Zvicrën, tregohen edhe histori dhe fatet e njerëzve të migruar. Sa migracion ka tek unë? Kjo pyetje shoqëron vizitorët në turneun e ekspozitës dhe i fton ata të merren me temën e migracionit si në kontekstin historik ashtu edhe në lidhje me historinë e tyre jetësore dhe origjinën e tyre. Pasi: Migrimi në historinë njerëzore ishte dhe është rast normal.

## Analiza e SGB/USS: Solidariteti është parakushti për të ardhmen e demokracisë

Orientimi gjithnjë e më ekonomik dhe liberal i politikës sociale dhe ekonomike në 30 vitet e fundit ka çuar në një de-solidarizim në Zvicër. Ky është treguesi i një analize të SGB/USS. Sidoqoftë, ndryshe nga vendet e tjera, gjërat më të këqija kanë arritur të parandalohen falë ofensivave sindikale mbi kontratat kolektive të punës dhe për pagat minimale, por edhe luftës të suksesshme mbrojtëse të sigurimit të pleqërisë. Edhe në vitin 2020, sindikatat do të jenë përsëri në ofensivë: për të forcuar AHV/AVS-in duke filluar iniciativën për një pension të 13-të të AHV/AVS-it në muajin mars dhe për një kompromis partneriteti social të BV/PP (fondi pensional) për të mundësuar një situatë më të mirë pensionesh për gratë, për punëtorët me kohë të pjesshme dhe me të ardhurat më të ulëta, dhe kundër dobësimit të Propozimit të Qeverisë Federale për një kompensim urgjent për të moshuarit e papunë. Nevojitet më shumë solidaritet për çështjet sociale, gjë që po e bëjnë sindikatat.

# Fushatë ndërkombëtare e Unia Të ndalohet asbesti në gjithë botën!

Asbesti është një material i rrezikshëm: mijëra njerëz kanë vdekur prej tij. Por miliona punëtorë në të gjithë botën akoma vijnë në kontakt me materialin kancerogjen. Së bashku me Solidar Suisse, Unia është duke bërë fushatë për një ndalim në të gjithë botën.

Pepo Hofstetter

Asbesti ka 30 vjet që është ndaluar në Zvicër. Por jo në shumë vende të tjera, veçanërisht vendet më të varfra. Asbesti atje përdoret akoma pa hezituar. Vende të mëdha prodhuese si Rusia deri më tani ia kanë arritur për penguar ndalimin. Me pasojë shkatërruese: Më shumë se 100 000 njerëz vdesin çdo vit nga sëmundjet e lidhura me asbestin.

Prandaj Unia po bën fushatë për ndalimin e azbestit në të gjithë botën. Përmes organizatës për ndihmë dhe bamirësi Solidar Suisse, ajo mbështet fushatat sindikale në vende të ndryshme të Azisë që kërkojnë mbrojtje më të mirë dhe kujdes më të madh për të prekurit, si dhe një ndalim të përgjithshëm.

### Mbështetje për demoluesit e anijeve transportuese

Që nga starti i ISAB/SIAC në mars 2019 për shembull në Bangladesh. Në qytetin lima të Chittagong, rreth 100 000 njerëz jetojnë nga copëzimi i anijeve të vjetra. Puna e tyre është njëra nga më të rrezikshmet në botë. Në kushte të pasigurta dhe në pagat e varfra, ata demo-



«Puna më errezkshme në botë»: demoluesit e anijeve në Bangladesh

lojnë transportuesit e vjetër, cisternat dhe anijet lundruese dhe shpesh vijnë në kontakt me asbestin. Vlerësohet se

një e treta e të punësuarve janë sëmurë nga asbesti – mungojnë shifrat e sakta. Kompanitë zvicerane të anijeve (MSC) gjithashtu lënë për ti demoluara anijet e tyre me çmim të ulët në Chittagong.

Sindikatat e pavarura janë të përkushtuara për të drejtat e transportit të anijeve dhe mbrojtje më të mirë shëndetësore. Unia dhe Solidar Suisse mbështesin këtë punë të rëndësishme.

### Fondi i Kompensimit në Zvicër

Me gjithë ndalimin e asbestit, edhe më tej, për çdo vit në Zvicër vuajnë 120 njerëz nga tumori malinj. Pasi një sëmundje mund të shpërthejë edhe pas 20 ose më shumë viteve. Edhe sot, kujdes i lartë vlen për punën e rinovimit të ndërtesave që janë ndërtuar para vitit 1990.

Sëmundjet e asbestit përgjithësisht njihen si sëmundje profesionale. Për të mbështetur më mirë të prekurit, Fondi i Kompensimit për Viktimat e Asbestit (EFA) që nga viti 2017 ka ofruar këshillime psikologjike në tri gjuhë dhe mbështetje financiare. Fondi është i hapur për njerëzit që janë të sëmurë për shkak të kontaktit me asbestin në Zvicër. Kjo vlen gjithashtu nëse ata tani jetojnë jashtë vendit.

Informata tjera: [www.stiftung-efa.ch](http://www.stiftung-efa.ch) ose tek Unia e regjionit Tuaj.

## Delegatët e ri të migracionit në kryesinë qendrore Zë i migracionit në sindikatën Unia

Migracioni i Unia përsëri është i përfaqësuar në përbërje të plotë të delegatëve në kryesinë qendrore. Qysh në mbledhjen e pare ky delegacion arriti të bashkë-diskutoi temat dhe fushatat e rëndësishme dhe kështu të adresojë kërkesat dhe çështjet e migracionit.

Emine Sariaslan

Mbledhja e përgjithshme e delegatëve të Unia me 7 dhjetor zgjodhi Eleonora Failla, Emine Sariaslan, Elio Li Voti dhe Hilmi Gashin si përfaqësues të migracionit në kryesinë qendrore. Katër delegatët paraprakisht ishin nomiuar nga komisioni I magracionit. Kryesia (Bordi) qendrore është një organ ekzekutiv i zgjeruar i Unia që përbëhet nga anëtarët e udhëheqësish ekzekutive, sekretarët regjionalë dhe anëtarët e zgjedhur të sektorëve dhe grupeve të interesit.

### 2020: Unia Lufton për të drejtat e punonjësve

Në mbledhjen e kryesisë qendrore në dhjetor 2019, sindikata Unia vendosi objektivat e saj për vitin 2020. Në vitin



Përfaqësuesit e zgjedhur të migracionit në kryesinë qendrore

2020, Unia do të vazhdojë të bëjë fushatë për të drejtat e punëtorëve, të migrantëve, për të drejta të barabarta dhe do të angazhohet për një shoqëri sociale dhe të drejtë si dhe do të luftojë sulmet ndaj ligjit të punës si dhe diskriminimin dhe racizmin.

### Të luftohet nisma e anulimit e SVP/UDC

Lufta kundër iniciativës së shkarkimit të SVP/UDC është e rëndësishme këtë vit. Kjo nismë don të shfuqizojë lëvizjen e lirë të njerëzve me BE-në. Si pasojë kjo do të kishte edhe përfundimin e «masave shoqërore» që mbrojnë pagat tona. Pa kontrolle dhe sanksione, kontratat kolektive të punës, të cilat sot sigurojnë pagat dhe kushtet e punës së dy milion punonjësve në Zvicër, nuk do të mund të zbatoheshin më. Prandaj nisma do të shkaktonte një ortek gjigand të dumpingut në pagat - rënies së pagave dhe kushteve gjithnjë e më të pasigurta e të përkeqësuar të punësimit. Prandaj kjo nisma është një

sulm i paparë për të drejtat e të gjithë punëtorëve.

### Greva klimatike

Ngrohja globale po merr përmasa katastrofale dhe kërkon veprim të menjëhershëm. Unia bën thirrje për investime në prodhimin dhe metodat e ndërtimit ekologjikisht të qëndrueshme, krijimin e vendeve të punës në «ekonominë e gjelbër», një kthesë energjetike me qëllim të neutralizimit të karbonit dhe forcimin e shërbimit publik, veçanërisht në degën e komunikacionit dhe transportit. Përfituesit e vërtetë të shkakuarit e emergjencës klimatike duhet të paguajnë kostot e sanimit. Taksat transformuese dhe kostoja e transformimit duhet të mënyrë të plotë dhe me marrëveshje shoqërore t'i kthehen popullatës së përgjithshme. Duke marrë në konsiderim të gjitha këto, Unia më 15 maj 2020 do të mbështet gjithashtu «grevën klimatike» të nisur nga «Rinia klimatike».

# Reforma tatimore dhe financimi i AHV (STAF/RFFA) Siguimet Shoqërore: Çka ndryshon me 2020?

Më 1 janar 2020, hyri në fuqi reforma e taksave dhe financimi i AHV (STAF/RFFA), e cila u miratua nga votuesit me 66.4% vota pro. Për herë të parë pas mbi 40 vjetëve, po rritet niveli i kontributit AHV të punëdhënësve, të punësuarve, të vetë punësuarve dhe joaktivëve. Shkalla e kontributit të fondit të kompensimit familjar do të ndryshon gjithashtu.

Marek Wieruszewski

Qëllimi i kësaj reforme ishte forcimi i sistemit në luhatje të AHV/AVS me qëllim të sigurimit të pensioneve në të ardhmen. Përmes kësaj reforme AHV/AVS merr edhe 2 miliardë CHF shtesë në vit: 1.2 miliardë i bartin punëdhënësit dhe të siguruarit. Pjesa tjetër paguhet nga qeveria federale.

## Ndryshimi i kontributeve AHV/AVS

Kontributi i pagave në AHV rritet për 0.3% (nga 8.4 në 8.7%) dhe paguhet përgjysmë nga punonjësit dhe punëdhënësit (secili nga 0.15%). Kjo korrespondon me një rritje prej 1.50 CHF të secilës pagë 1000 frangash. Të vetë punësuarit duhet të financojnë vetë 0.3%. Tek të ardhura vjetore mbi 56 900, kontributi i AHV rritet nga 7.55% në 8.1%. Një shkallë degresive prej 7.55 deri në 4.32% vlen për njerëzit që fitojnë të ardhura më të ulëta. Më shumë informacion mund të gjeni në fletën e informacionit: [www.ahv-iv.ch/p/1.2020.d](http://www.ahv-iv.ch/p/1.2020.d)

	I vjetër	I ri
<b>Punëmarrësit</b>		
AHV/AVS Kontributi	4,2%	4,35%
AHV/IV/EO/AVS/AI/APG Kontributi	5,125%	5,275%
<b>Punëmarrësit</b>		
<b>Te vetëpunësuarit</b>		
Të ardhura vjetore mbi 56 900	7,8%	8,1%
9400 deri 56 900		mes 7,55% dhe 4,35%
Deri 9400	395	409
AHV/AVS kontribut minimal		
<b>Të papunësuarit</b>		
Kontributi minimal pasuri mbi 300 000 CHF	482	496
Kontributi maksimal nga 8 400 000 CHF	24 100	24 800
<b>AHV/AVS vullnetar</b>		
Kontributi minimal	922	950
Kontributi maksimal	23 050	23 750

	2019	2020
<b>Basel-Stadt</b>		
Shtesat e fëmijëve	200	275
Shtesat arsimore	250	325
<b>St. Gallen</b>		
Shtesat e fëmijëve	200	230
Shtesat arsimore	250	280
<b>Freiburg</b>		
Shtesat e fëmijëve për dy fëmijët e parë	245	265
Për secilin fëmijë vijues	265	285
Shtesat arsimore (deri në 2 fëmijë)	305	325
Për secilin fëmijë të tretë	325	345
<b>Appenzell Innerhoden</b>		
Shtesat e fëmijëve	200	230
Shtesat arsimore	250	280
<b>Jura</b>		
Shtesat e fëmijëve	250	275
Shtesat arsimore	300	325
<b>Schaffhausen</b>		
Shtesat e fëmijëve	200	230
Shtesat arsimore	250	290

## Kantonet rrisin shtesat e fëmijëve

Përveç kësaj, në kuadër të zbatimit kantonal të parashtresës së taksave, nga 1 janari 2020 shtesat për fëmijë dhe ato arsimore do të rriten në gjashtë kantone: Rritjet e mëposhtme do të vlejnjë në kantonin e Appenzell Ausserhoden nga 1 Prilli 2020: shtesa për fëmijë: 230 (më parë 200) dhe shtesat arsimore: 280 (më parë 250).

Rritja e shtesave mund të rezultojë që personat e punësuar do të kenë të drejtë të marrin pagë në diferencën nëse prindi tjetër merr ndihma më të ulëta për të njëjtët fëmijë në një kanton tjetër pune.

## Pensionet profesionale

Nga 1 janari 2020 pensionet e ndryshme të trashëgimtarëve dhe të pensionet e invaliditetit në shtyllën e dytë të detyrueshme për herë të parë do të përshtaten në zhvillimet e çmimeve. Pensionet e paguara për herë të parë në vitin 2016 rriten me 1.8%, pensionet në 2010, 2013 dhe 2014 do të rriten me 0.1%. Për bezdinë e punëdhënësve, bilancet në pjesën e detyrueshme të planit të pensionit profesional do të vazhdojnë të mbajnë interes të paktën 1% në vitin 2020. Sa më e madhe shkalla, aq më shumë rritet pasuria e të siguruarit.

# E drejta e votës për të huajt në Kantonin e Cyrihut heq pengesën e parë Atë që don Cyrihu, Jura ka kohë që e posedon

Të djathtit tek e drejta e të huajve për të votuar u errën sytë. Por 600 komuna tashmë kanë dhënë dritën e gjelbër. Cyrihu tani është duke bërë një përpjekje të re.

ANNE-SOPHIE ZBINDEN, work, Nr. 1/17 janar 2020 (i shkurtuar)

Ajo që duket revolucionare për Zvicrën gjermanofolëse në Zvicrën perëndimore është pothuajse normale: e drejta komunale për të huajt për të votuar dhe për të zgjedhur. Parlamenti Kantonal i Cyrihut tani është gati të debatojë për këtë çështje. Në mënyrë të veçantë, komunave të Cyrihut duhet t'u jepet mundësia të prezantojnë të drejtat komunale për të huajt për të zgjedhur dhe për të votuar. Në rreth 600 komuna në të gjithë Zvicrën, njerëzit pa pasaportë zvicerane mund të marrin pjesë në zgjedhje, votojnë dhe të zgjidhen. Jura ishte kantoni i parë, që në 1979 fuqizojë të drejtën komunale zgjedhore edhe për të huajt. Që nga fillimi i viteve nëntëdhjeta kjo vlen gjithashtu edhe për zgjedhjet komunale të Kantoneve Vaud, Gjenevë dhe Freiburg. Në Jura dhe Neuchâtel deri edhe zgjedhje dhe votim kantonal.

## Prijnë malokët

Zvicra gjermanofolëse ka mbetur mbrapa në të drejtat e votimit për të huajt – me tre përjashtime: Në Basel-Stadt (2005), Graubünden (2003) dhe Appenzell Ausserrhoden (1995), komunat mund të lejojnë votimin e të huajve. Kjo tani po diskutohet në Bazel. Në Graubünden, të huajt mund të votojnë në mbi 20 komuna. Kështu fjala bie që nga viti 2012 në komunën Vals. Kryetari i Bashkisë Stefan Schmid thotë: «Në Vals krahasuar me komunat tjera malore ka shumë të huaj.» Andaj është e drejtë dhe gjithashtu e rëndësishme që ata të mund të përfshihen në politikë.

## Kantoni Appenzell më përparimtar

Appenzell Ausserrhoden, Kantoni i cili fuqizoi të drejtën e grave për të votuar tek në vitin 1989, sa i përket të drejtës të të huajve për të votuar është më përparimtar. Në katër komuna të rriturit pa pasaportë zvicerane mund të bashkëvendosin politikisht: në Wald, Trogen, Rehetobel dhe Speicher.

## Rrugë shkëmbore

Në Cyrih, votuesit e refuzuan këtë kërkesë përsëritshëm me 1993 dhe me 2013. Edhe iniciativa e re ka një rrugë të vështirë përpara: Tani Komisioni Ligjor po shqyrton projekt-ligjin para se ai të vijë për herë të dytë në Parlament – dhe më pas do ti nënshtrohet edhe referendumit popullor.

## Intervista



Me 17 maj 2020 votuesit zviceran do të vendosin mbi «iniciativën përfunduese» të SVP/UDC. Serge Gnoss, drejtues i sektorit për komunikim në Unia shpjegon për Horizonte se çka në të vërtetë fshihet pas kësaj iniciative.

Serge, SVP/UDC atë e emërton si iniciativë popullore «Nisma për imigrim të moderuar (nismë kufizuese)». Çka synon SVP/UDC me këtë nismë?

Vet titulli është një pako false. Nisma e SVP/UDC është gjithçka tjetër përveç se «e moderuar»; është një sulm i drejtpërdrejtë ndaj të drejtave të të gjithë punonjësve në Zvicër. Nëse miratohet, lëvizja e lirë e njerëzve me Bashkimin Evropian dhe mbrojtja e pagave në Zvicër do të shfuqizoheshin. Kjo është e pamash dhe e tepruar, jo e moderuar.

Unia dhe organizatat e tjera e quajnë atë «nismë përfundimi». Pse?

SVP/UDC është mjeshtër në mbulimin e qëllimeve të saja të vërteta. Politikat e saja gjithmonë u shërbejnë të pasurve dhe të fuqishmëve; Por fajtor për ta janë gjithmonë të tjerët – migrantët, punëtorët, njerëzit me të ardhura të ulëta. Këtë ne mund ta vërejmë edhe tek kjo iniciativë: Qëllimi i dekluarit i SVP/UDC është ti jap fund lëvizjes së lirë të personave; për të ndaluar përfundimisht migrimin. Ky është boshti i debatit që duhet edhe të emërohet si i tillë. Gjithçka tjetër është përpjekje për mashtrim dhe i shkon për shtati SVP/UDC.

Pse Unia e konsideron të rrezikshme nismën?

SVP/UDC po sulmon të drejtat e të gjithë punonjësve: dëshiron të heqë mbrojtjen e pagave dhe kështu edhe pagat korrekte dhe kushtet e mira të punës. Për më tepër, po kërcënon të kthehet statusi diskriminues sezonal. Ne duhet t'i luftojmë të dyja me vendosmëri. Falë masave mbrojtëse shoqëruese për lëvizjen e lirë të njerëzve, ne arritëm të fuqizojmë instrumente për mbrojtje më të mirë të pagave. Si rezultat, në 10 vitet e fundit ne kemi arritur të përmirësojmë kushtet e punës dhe në vazhdimësi të rrisim nivelin e pagave të ulëta. Këtë veçanërisht në degët e industrisë, në të cilat neve për vite me radhë na ka hasur sharra në gozhdë - siç është rasti tek dega e pastrimit ose e personelit të huazuar. Ne gjithashtu hapa pas hapi arritëm të frenonim dumpingun e pagave dhe punën e padeklaruar (në të zezë). Si sindikata, ne për dekada jemi angazhuar për më shumë të drejta për migrantet e migrantët. Lëvizja e lirë e njerëzve ishte një hap i madh përpara për qytetarët e BE-së. Kjo na ka dhënë të gjithëve të drejtën të zgjedhim se ku brenda BE-së duam të punojmë dhe jetojmë. Kjo është një arritje kryesore, të cilën ne duhet ta mbrojmë. Nisma është e rrezikshme sepse vë në dyshim të gjitha këto arritje të rëndësishme për punonjësit. SVP/UDC dëshiron ta kthejë Zvicrën 20 vjet prapa. Ajo dëshiron që të kthehet Zvicra e barakave, e cila i toleron migrantët si punëtorë sezonalë, por ti privon ata nga çdo e drejtë tjetër. Të paktën, kështu ishte në një kohë kur sindikatat ishin të dobëta dhe të frikësuar dhe veprimi luftarak sindikaliste kryeshin vetëm në raste të jashtëzakonshme. Në një kohë kur patronët kishin fjalën kryesore dhe askush nuk guxoi të bëzante. Asnjë nga kjo nuk ka të bëjë me idenë tonë për Zvicrën; ne duhet dhe ne do ta pengojmë atë.

Qytetarët/ët e BE-së do ishin të prekurit, por jo edhe migrantët e tjerë, p.sh. ata nga vendet e treta.

Jo, kjo nuk qëndron si e tillë. Është e vërtetë që migrantët nga vendet e treta nuk mund të përfitojnë nga lëvizja e lirë e njerëzve. Por edhe ata kanë nevojë për paga të mira dhe kushte të mira pune; gjithashtu ata kanë nevojë për mbrojtje të pagave. Ashtu sikur zviceranët/ët. Ne këtu jemi të gjithë në të njëjtën anije.

A nuk është e vërtetë se kufizimi i imigracionit do të zgjidhte shumë probleme në botën e punës?

Kjo është e pakuptimtë. Emigracioni nuk është problemi; Shfrytëzimi dhe lakmia janë problemi. Ekziston kjo histori: një migrant, një banor dhe një mbrojtës ulen rreth një torte të ndarë në 10 copë. Patroni merr 9 prej tyre dhe i thotë banorit vendas: «Kujdes, migranti dëshiron të ta merr tortën tënde». SVP/UDC-ja tregon saktësisht këtë histori.

## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Të punuarit si pensionist: A duhet të paguajë kontribute në AHV/AVS?

**Së shpejti unë mbushi 65 vjet dhe pastaj do të marrë pensionin e AHV/AVS-it dhe atë të arkës pensionale. Mirëpo unë dua pjesërisht që të punojë më tej edhe pas pensionimit. A duhet unë të vazhdojë të paguajë kontribute në arkën e sigurimit të pleqërisë AVH/AVS?**

**PHILIP THOMAS:** Po. Pasi obligimi i kontributeve në arkën e AHV/AVS, IV/AI, EO/MSE nuk përfundon me përfitimim e pensionit të pleqërisë së AHV/AVS-it. Nëse fitoni më shumë se 1400.- franga në muaj (apo 16800 franga në vit), punëdhënësi duhet tua ndalë kontributet e AHV/AVS, IV/AI, EO/MSE dhe ti paguajë ato në arkat gjegjëse. E njëjta vlen edhe për sigurimin aksidental (UVG/LAA). Sigurimi Aksidental (UVG/LAA) nuk njihet kufi moshe. Punëdhënësi juaj duhet edhe më tej tua ndalë kontributet. Premitë e kontributeve bazohet në fitimin (të ardhurat) e siguruar. Përndryshe ju nuk duhet të paguani më në arkën e sigurimit të papunësisë dhe as në sigurimin profesional pensional (shtyllën e dytë BV/PP apo në arkën pensionale). Sa i përket sigurimit të të ardhurave të mëdijtes, vlen: Kushtet e përgjithshme të sigurimit dhe kontrata e siguruesit sqarojnë nëse duhet të vazhdoni të paguani kontribute dhe nëse sigurimi paguan përfitimim edhe në rast e të paftësisë për punë. Varësisht nga kushtet, mbulimi i sigurimit përfundon me arritjen e moshës 65 vjeçare.

Work, 13. 12. 2019

### Shkarkimi nga puna me 63 vjet: A duhet tani unë të pensionohem?

**Unë punoi në një shtypshkronjë. Mbarëvajtja e punëve në firmë nuk është e favorshme. Andaj mua në moshën 63 vjeç më kanë shkarkuar nga puna për arsye ekonomike. Firma ime nuk donë që të marrë pjesë në financimin e pensionimit tim të mëhershëm, por ka kërkuar nga unë që për këtë çështje të këshillohem. Unë e kam bërë këtë. Arka e pensionit më ka ofruar moshën e pensionimit me 63 vjet me shkallën e zakonshme të konvertimit prej 4,88. Pensioni im do të ishte aq i ulët, sa nuk do të arrinte për të jetuar. A do të më duhej megjithatë të pensionohem parkohet?**

**MARKUS WIDMER:** Jo. Më mirë është të lajmëroheni tek sigurimi i papunësisë. Nëse pranoni pensionimin e parakohshëm, atëherë arka e papunësisë do të përlllogariste pensionin tuaj në mëditjen e papunësisë dhe kështu mëditja juaj do të ishte më e ulët. Në vend të kësaj ne ju propozojmë që kapitalen e lirë që ju dispononi nga arka e pensionit ta ndani dhe të kërkonti që të deponohet në dy konto të ndryshme dhe në dy institucione të ndryshme bankare. Kompensimi nga arka e papunësisë përfundon më së voni me arritjen e moshës së pensionit të pleqërisë. Më pas mund ta tërhiqni në formë kapitali kapitalin e juaj të disponuar në kontot gjegjëse. Ne ju propozojmë që tërheqjen ta ndani në dy vite, pasi kështu ngarkesa tatimore do të ishte më ulët.

Work, 29.11.2019

### Konkursi (Falimentimi): A përfundon me këtë edhe marrëdhënia e punës?

**REGULA DICK:** Jo. Shpallja e falimentimit nuk domethënë automatikisht që marrëdhënia e juaj e punës përfundon. Sidoqoftë, ju nuk do të merrni kompensimin e falimentimit nga fondi i sigurimit të papunësisë për punën që bëni pasi të ketë filluar procedura e falimentimit. Kështu që ju rrezikoni të mos merrni kompensim për këtë kohë pune nëse procedurat e falimentimit tregojnë se ndërmarrja nuk ka më asete të mjaftueshme për të paguar pagat. Për më tepër, procedurat e falimentimit marrin një kohë relativisht të gjatë. Sidoqoftë, hapja e falimentimit konsiderohet një tregues se kompania nuk ka aftësi paguese. Sipas Nenit 337 a të së Drejtës Obligative Zvicerane, ju mund të kërkonti që pagat tuaja, të cilat duhet që t'ju paguhen në të ardhmen, të siguroheni, për shembull, që ato të paguhen në një llogari të bllokuar bankare. Vendosni punëdhënësin tuaj një afat kohor brenda të cilit ai juve duhet t'ua siguroi pagat tuaja në të ardhmen. Si afat i përshtatshëm konsiderohet afati nga tri ditë deri në një javë. Nëse brenda këtij afati nuk siguroheni për pagën tuaj, atëherë mund të lëshoni punën pa njoftim afati. Në këtë rast, lajmërohuni dhe regjistrohuni menjëherë në fondin e sigurimit të papunësisë.

Work, 17.01.2020

## Sfidat e vazhdueshme politike ndaj të huajve! E jani në mbrëmjen informative të Sindikatës Unia në gjuhën shqipe!



- **Lirim Begzati**, ekspert juridik në Neuchâtel
- **Osman Osmani**, Prointegra dhe udhëheqës i fushatës për pensione Kosovë-Zvicër
- **Hilmi Gashi**, udhëheqës i grupeve të interesit në Unia

### Cilat janë ndryshimet në Ligjin për të huaj dhe për integrim dhe çfarë domethënie kanë këto ndryshime në jetën e përditshme?

Ne do të ju informojmë mes tjerash mbi:

- Kriteret e reja të integritimit në ligjin për të huaj dhe integrim: degradimi i Lejes së përhershme të qëndrimit C në B, ndikimi i ndihmës sociale dhe pasojat për lejen e qëndrimit, kontratat për integrim
- Marrëveshja për pensione mes Kosovës dhe Zvicrës: Informimi, zbatimi dhe vështirësitë për pensionistët
- Iniciativa e SVPs kundër qarkullimit të lirë: Zhvillimet aktuale dhe të ardhshme

**KUR? E premtë, 28 shkurt 2020, prej orës: 18:30 – 22:00h**

**KU? Restoranti «Tscharnergut», Waldmannstrasse 21, 3027 Bern**

**KUSH? Të gjithë qytetarët e Bernës me rrethinë mund të marrin pjesë**

### Lajmërohu te:

Lajzim Bakija: 078 881 58 97, Sonia Oliveira: 079 595 01 44



**Grupi Aktivistët nga sindikata Unia dhe portali Prointegra organizojnë tubim informativ në gjuhën shqipe me temën:**

### Deklarimi i tatimit në Zvicër dhe marrëveshja për mënjanimin e tatimit të dyfishtë

**Tubimi mbahet me: 28.02.2020 nga ora 19 deri 21**

**Adresa: Strassburgstrasse 11 8004 Zürich (Kati 6)**



Tubimi është i hapur për të gjithë

**UNIA**

Das Bildungsinstitut der Gewerkschaften

### Planifikimi i pensionimit për migrant

Tani duam të dimë: Kur fillon sigurimi im në Zvicër? Si duket gjendja ime financiare pas pensionimit? Duke përfshirë eventualisht edhe përfitimim nga vendi im i origjinës, kontributet e sigurimit të pleqërisë dhe tarshëgimtarëve (AHV) si dhe shumën e kursyer në arkën e pensionit do të llogarisim përfitimim tona pas pensionimit.

<b>Përmbajtja</b>	Llogaritja e pensionit, shkëmbimi automatik i Informacioneve (AIA) Zvicër-Vendi i prejardhjes dhe pasojat, Aplikimi për përfitimim suplementare, Qendrat e kontaktit.
<b>Referenti</b>	Ruzhdi Ibrahim (Unia)
<b>Data</b>	28.03.2020 – 28.03.2020
<b>Kohëzgjatja</b>	1 ditë - pa fjetje
<b>Vendi</b>	Biel, Hotel City
<b>Çmimi i kursit</b>	Anëtarët: falas   Joanëtarët: Fr. 410.00
<b>Ushqimi</b>	Anëtarët: falas   Joanëtarët: Fr. 50.00

**Regjistrimi për pjesëmarrje:** (Regjistrimi më së voni 4 javë para fillimit të kursit)

**Planifikimi i pensionimit për migrantët | Data:** 28.03.2020 | **Numri i kursit:** B2.3.2006

<input type="checkbox"/> Femër	<input type="checkbox"/> Mashkull	<input type="checkbox"/> Gjuhë e korrespondencës:	<input type="checkbox"/> Gjermanisht	<input type="checkbox"/> Frëngjisht
<input type="checkbox"/> Mësimi	<input type="checkbox"/> Emri	<input type="checkbox"/> Profesioni	<input type="checkbox"/> Rrugja	<input type="checkbox"/> Kodi Postar
<input type="checkbox"/> Telefoni privat	<input type="checkbox"/> Telefoni i zyrës	<input type="checkbox"/> Telefoni mobil	<input type="checkbox"/> E-Mail	<input type="checkbox"/> Data e lindjes
<input type="checkbox"/> Unë jam anëtar i sindikatës	<input type="checkbox"/> Numri i anëtarësisë	<input type="checkbox"/> Unë kam një shtetësi në shtetësi:	<input type="checkbox"/> P. anëtar i:	<input type="checkbox"/> Përfqësues në firmë
<input type="checkbox"/> kryesi	<input type="checkbox"/> përa	<input type="checkbox"/> Data dhe nënshkrimi		

MOVENDO, Moribgustrasse 61, 3007 Bern - Telefon 031 379 00 75 - info@movendo.ch - www.movendo.ch